



QKSS

Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë

BAROMETRI KOSOVAR I SIGURISË

Edicion Special:

Perceptimet e qytetarëve për integritetin
në Policinë e Kosovës





QKSS

Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë

BAROMETRI KOSOVAR I SIGURISË

Edicion Special:

Perceptimet e qytetarëve për integritetin
në Policinë e Kosovës

Botues: Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë

Projekti u mbështet nga: National Endowment for Democracy

Interpretues i të dhënave: Plator Avdiu

Redaktimi i brendshëm: Florian Qehaja dhe Mentor Vrajolli

Redaktimi i jashtëm: Shpend Kursani

Shkurt 2016

Shënim: Ky raport në formën e tij origjinale është shkruar në gjuhën angleze.

© Të gjitha të drejtat janë të rezervuara nga Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë. Të drejtat dhe pronësia intelektuale mbrohen me Ligjin për të drejtat e autorit dhe të drejtat e përafërta.

Asnjë pjesë e këtij publikimi nuk mund të riprodhohet, të ruhet në ndonjë sistem të ruajtjes ose të transmetohet në ndonjë formë apo me ndonjë mjet elektronik, mekanik ose ndryshe, pa lejen me shkrim nga botuesi. Përdorimi për qëllime komerciale i të gjitha raporteve të publikuara nga Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë nuk lejohet pa pëlqimin me shkrim të Qendrës Kosovare për Studime të Sigurisë. Ju lutem kontaktoni: info@qkss.org ose +381 38 221 420

Informatat e paraqitura në këtë raport janë përmbledhje e të dhënave të grumbulluara nga të anketuarit dhe duhet të trajtohen vetëm si të tilla. Ky raport nuk është në asnjë mënyrë vlerësim definitiv i cilësisë së punës së institucioneve që janë objekt i këtij studimi. Ky raport u shërben atyre si instrument për adresimin e mangësive të mundshme dhe njëherësh është tregues i efikasitetit të komunikimit të tyre me popullin.

Pikëpamjet e paraqitura në këtë raport janë perceptime të të anketuarve dhe nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e Qendrës Kosovare për Studime të Sigurisë. Mendimet e shprehura në këtë raport nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e National Endowment for Democracy.

PËRMBAJTJA

ÇKA ËSHTË BAROMETRI KOSOVAR I SIGURISË?	7
KUJT I DREJTOHET KY EDICION SPECIAL?	7
NDIKIMI.....	7
METODOLOGJIA	8
HYRJE.....	9
GJETJET KRYESORE	9
1.1. Besueshmëria në Policinë e Kosovës sipas rajoneve	12
1.2. Besueshmëria në Policinë e Kosovës sipas përkatësisë etnike.....	13
2. KONTAKTET E DREJTPËRDREJTA TË QYTETARËVE TË KOSOVËS ME POLICINË E KOSOVËS	15
3. KORRUPSIONI NË POLICINË E KOSOVËS	19
4. (MOS)NDIKIMI POLITIK NË POLICI	23
5. BASHKËPUNIMI NDËRMJET POLICISË DHE QYTETARËVE	24
6. PERCEPTIMI I QYTETARËVE PËR INSPEKTORATIN POLICOR TË KOSOVËS.....	26
BIBLIOGRAFIA	28

LISTA E FIGURAVE

Figura 1 – Besueshmëria në Policinë e Kosovës	11
Figura 2 – “Besueshmëria në Policinë e Kosovës sipas rajoneve të Kosovës	13
Figura 3 – Besueshmëria në Policinë e Kosovës sipas përkatësisë etnike	14
Figura 4 – Kontaktet e qytetarëve të Kosovës me Policinë e Kosovës dhe institucionet e tjera të sigurisë	16
Figura 5 – Kontaktet e qytetarëve të Kosovës me Policinë e Kosovës sipas rajoneve të Kosovës.....	16
Figura 6 – Kontaktet e qytetarëve të Kosovës me Forcën e Sigurisë së Kosovës sipas rajoneve të Kosovës	17
Figura 7 – Kontaktet e qytetarëve të Kosovës me KFOR-in sipas rajoneve të Kosovës	17
Figura 8 – Kontaktet e qytetarëve të Kosovës me njësitë e Policisë së Kosovës	18
Figura 9 – Perceptimet e qytetarëve për korrupsionin në Policinë e Kosovës.....	19
Figura 10 – Perceptimet e qytetarëve për korrupsionin në Policinë e Kosovës sipas rajoneve të Kosovës.....	20
Figura 11 – Përvojat e qytetarëve me korrupsion gjatë kontaktit të tyre me Policinë e Kosovës.....	21
Figura 12 – Perceptimet e qytetarëve se kujt do t’i raportonin për rastet e korrupsionit në Polici	22
Figura 13 – Perceptimet e qytetarëve se kush duhet ta luftojë korrupsionin në Polici.....	23
Figura 14 – Perceptimet e qytetarëve se kujt i shërben Policia e Kosovës.....	24
Figura 15 – Pengesat kryesore ndaj bashkëpunimit të qytetarëve me policët.....	24
Figura 16 – Përmirësimi i sigurisë publike	25
Figura 17 – Besueshmëria në Inspektoratin Policor të Kosovës.....	26
Figura 18 – Kontaktet e qytetarëve të Kosovës me Inspektoratin Policor të Kosovës	27

ÇKA ËSHTË BAROMETRI KOSOVAR I SIGURISË?

Barometri Kosovar i Sigurisë (BKS) është program i veçantë i Qendrës Kosovare për Studime të Sigurisë (QKSS) i hartuar për të shërbyer si publikim vjetor. Përveç gjetjeve të përgjithshme, programi nxjerrë edicione speciale në fusha të përcaktuara paraprakisht. Fokusi kryesor i BKS-së është matja e perceptimeve të opinionit publik për institucionet dhe politikëbërjen në fushën e sigurisë. Gjithashtu, ai mat perceptimin publik për kërcënimet e brendshme dhe të jashtme ndaj sigurisë në Kosovë. BKS-ja është një nga nismat më të mëdha, madje ndër të parat, që janë hartuar, zbatuar dhe komunikuar nga një institut vendor këshillëdhënës. QKSS-ja nuk ka asnjë detyrim politik në komunikimin e të gjeturave dhe porosive. Në fund, BKS-ja është unike në qasjen e vet metodologjike, siç është përshtatja e metodave kuantitative dhe kualitative me qëllim të ofrimit të rezultateve reale për perceptimin publik sa i përket çështjeve të lidhura me sigurinë.

KUJT I DREJTOHET KY EDICION SPECIAL?

Ky edicion special i BKS-së i drejtohet një game të gjerë të akterëve që janë të interesuar t'i përcjellin perceptimet e qytetarëve për integritetin në Policinë e Kosovës (PK). Më saktësisht, ai i drejtohet një audience që është e interesuar t'i ndjekë trendët e opinionit publik në Kosovë, me theks të veçantë në besueshmërinë e publikut ndaj PK-së dhe Inspektoratit Policor të Kosovës (IPK), shpeshhtësinë e kontakteve të qytetarëve me PK-në dhe njësitë përkatëse të saj, perceptimin për korrupsionin në radhët e PK-së, si dhe sigurinë publike. Në përgjithësi, BKS-ja u drejtohet politikëbërësve në nivel kombëtar, pranisë ndërkombëtare në Kosovë, si edhe organizatave vendore, rajonale e ndërkombëtare të shoqërisë civile, komunitetit akademik dhe mediave.

NDIKIMI

Ndikimi i BKS-së pritet që të shumëfishohet në periudhën afatmesme për disa arsye, duke marrë parasysh (a) rritjen e vazhdueshme të besueshmërisë së QKSS-së si një organizatë profesionale e pavarur dhe pa prapavijë politike, (b) përvoja e gjatë e QKSS-së në zbatimin e metodave të duhura shkencore në hulumtimet e veta, (c) rëndësia për fuqizimin e rolit të ekspertizës vendore, si dhe (d) kapacitetet profesionale që QKSS-ja disponon. Botimet e mëparshme të BKS-së janë dëshmi e përbushjes së këtyre katër qëllimeve të sipërpërmendura.

METODOLOGJIA

Ky edicion special i BKS-së pasqyron perceptimet e qytetarëve për integritetin në PK. Kjo u ka bërë të mundur interpretuesve të të dhënave të bëjnë një analizë në mënyrë të hollësishme perceptimet e qytetarëve. Interpretimi pasqyron një grup faktorësh politik dhe shoqërorë që kanë ndikuar në mendimin e të anketuarve. Analizimi i opinionit të qytetarëve bazohet edhe në përfshirjen e drejtpërdrejtë të interpretuesit të të dhënave në intervistat e drejtpërdrejta me të anketuarit. Për më tepër, përpjekjet e ekipit të QKSS-së për shkoqitjen dhe analizën e mëtejme të mendimeve të përfshira në këtë edicion special janë mbështetur nga grupet e fokusit me hulumtuesit e terrenit.

Përgjigjet në pyetësonin e BKS-së janë mbledhur përmes intervistave të drejtpërdrejta që u realizuan në tërë territorin e Republikës së Kosovës. Shumica e pyetjeve ishin të llojit të mbyllur në formë të shkallës pesë-pikëshe të Likertit. Disa pyetje ishin të hapura për t'u dhënë të anketuarve mundësinë që të jepnin mendimin e tyre pa qenë nevoja të zgjedhin opsione të përcaktuara paraprakisht. Mostrimi, pilotimi dhe intervistimi u realizuan nga ekipi i QKSS-së në përbërje të 35 hulumtuesve në terren. Mostra kombëtare mbi bazën e së cilës u hartua hulumtimi përmbante 1,070 amvisëri, duke ndjekur një mostër përfaqësuese të popullatës mbi moshën 18 vjeçare në Kosovë. Përbërja etnike e të anketuarve ishte si vijon: 88.4 përqind shqiptarë të Kosovës, 7.7 përqind serbë të Kosovës dhe 3.9 përqind të tjerë (prej të cilëve 1.4 përqind turq, 0.6 përqind boshnjakë, 1.0 përqind RAE dhe të tjerët përfshijnë goranë, kroatë dhe malazezë).

Korniza e mostrës ishte e bazuar në kodet telefonike të rajoneve dhe si e tillë ka përfshirë 7 rajonet në vijim: Ferizajn, Gjakovën, Gjilanin, Mitrovicën, Pejën, Prishtinën dhe Prizrenin. Faza e parë e grupimit gjeografik ishte e bazuar në Raportin e Regjistrimit të Popullsisë së Kosovës të vitit 2012, ndërsa faza e dytë ka përfshirë grupimin e mostrave sipas zonave komunale me mostër të stratifikuar fshat/qytet sipas numrit të ekonomive shtëpiake. Kurse, në fazën e fundit u zbatua metoda e mostrës së rastit, duke shfrytëzuar "metodën e ditëlindjes" më të afërt. Mostrimi sipas rastit garanton që secili banor në Kosovë të ketë mundësi të barabartë për t'u përzgjedhur për intervistim. Me mostrën e përdorur për këtë studim, rezultatet e anketës pasqyrojnë trendët në qëndrimet dhe perceptimet e gjithë popullsisë së moshës madhore të Kosovës në përgjithësi. Margjina e gabimit është 3 përqind, me një interval besueshmërie prej 95 përqind.

Para fillimit të punës në terren, në fillim të tetorit të vitit 2015 u realizua një pilot intervistë me qëllim të testimit të realizueshmërisë së pyetësonit. Ekipi hulumtues më pas raportoi se pilot intervista kishte qenë e suksesshme dhe se nuk ishte hasur ndonjë problem me pyetjet që u ishin bërë të anketuarve. Të gjitha intervistat u realizuan nga 21 deri më 29 tetor 2015. Përpunimi dhe analiza e të dhënave janë bërë duke përdorur softuerin SPSS.

HYRJE

Ky edicion special i Barometrit Kosovar të Sigurisë paraqet analizën e perceptimit publik në Kosovë përkthazi me integritetin në radhët e Policisë. Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë e konsideron integritetin si pjesë të domosdoshme të qeverisjes së mirë të administratës publike. Për ta monitoruar dhe vlerësuar shkallën e qeverisjes së mirë në Policinë e Kosovës, ka qenë thelbësore që të përfshiheshin perceptimet e qytetarëve për një sërë çështjesh të lidhura me integritetin e zyrtarëve policorë në Kosovë. Ky edicion i Barometrit Kosovar të Sigurisë ofron një interpretim gjithëpërfshirës dhe të hollësishëm të të dhënave që kanë të bëjnë me perceptimet e opinionit publik, duke u bazuar në një grup pyetjesh të përcaktuara paraprakisht për çështjen në fjalë.

GJETJET KRYESORE

- Publiku në Kosovë ka qëndrim përgjithësisht pozitiv ndaj Policisë së Kosovës dhe një përshtypje e tillë është hasur tek të gjitha komunitetet e Kosovës. Sipas të gjeturave tona, shumica e të anketuarve (56 përqind) kanë shprehur shkallë të lartë të besueshmërisë ndaj këtij institucioni.
- Të anketuarit e kanë krijuar një perceptim të tillë kryesisht në bazë të përvojës personale dhe kontaktit të drejtpërdrejtë me Policinë e Kosovës (58 përqind). Kjo do të thotë se mendimet e shprehura kanë qenë më të sinqerta dhe nuk i kanë krijuar përmes palëve të treta, siç janë mediat dhe palët tjera të treta që mund të kenë ndikim në opinionin e përgjithshëm publik.
- Policia e Trafikut dhe Policia Kufitare kanë pasur nivelin më të madh të ndërveprimit dhe komunikimit me qytetarët. Ndonëse është pritur që policimi në bashkësi të jetë në krye të listës kur bëhet fjalë për kontaktet e drejtpërdrejta me qytetarët, kjo nuk ka ndodhur për shkak se koncepti i policimit në bashkësi nuk është zhvilluar ende sa duhet dhe për shkak të zbatimit të kufizuar në terren.
- Korrupsioni, si një nga aspektet më problematike të integritetit në Polici, perceptohet nga qytetarët së është i pranishëm në Policinë e Kosovës. Sidoqoftë, perceptimi i qytetarëve për korrupsionin në këtë institucion është më i ulët

kur kjo krahasohet me institucionet e tjera në vend.¹ Më pak se 30 përqind e qytetarëve mendojnë se Policia e Kosovës ka qenë e prekur nga korrupsioni në vitin 2015, derisa mbi 40 përqind janë shprehur se ajo nuk është e korruptuar.

- Përkundër faktit që Policia e Kosovës është kritikuar nga palë të ndryshme se është nën ndikimin politik, shumica e të anketuarve (53 përqind) kanë thënë se Policia e Kosovës i mbrohet interesat e qytetarëve, në krahasim me 23 përqind sosh të cilët janë shprehur se Policia është vënë në shërbim të Qeverisë së Kosovës dhe 12 përqind të tjerë që kanë qenë të mendimit se Policia u shërben vetëm interesave të partive politike.
- Gjithashtu, gjetjet sugjerojnë se ka pengesa që e vështirësojnë bashkëpunimin mes qytetarëve dhe Policisë së Kosovës. Qytetarët nuk ndjehen të sigurt kur bëhet fjalë për mbrojtjen e të dhënave të tyre personale dhe për mundësinë e keqpërdorimit të privatësisë.
- Në fund, gjetjet tregojnë se qytetarët i besojnë më pak Inspektoratit Policor të Kosovës në krahasim me Policinë e Kosovës. Rreth 40 përqind e të anketuarve i besojnë punës së Inspektoratit Policor të Kosovës, derisa 30 përqind prej tyre nuk i besojnë.


¹ (Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë, 2015, fq. 16-17).

1. BESUESHMËRIA E QYTETARËVE NË POLICINË E KOSOVËS

Viti 2015 ka shënuar ndër periudhat më sfiduese për Policinë e Kosovës (PK) për shkak të protestave të shpeshta e të dhunshme me të cilat i është dashur të ballafaqohet dhe barrës së situatës së sigurisë gjatë ngërçit politik në vend. Përkundër pranisë së shpeshtë nëpër rrugë (nganjëherë edhe përdorimit të forcës së tepruar) besueshmëria ndaj Policisë ka mbetur e palëkundur. Madje, besueshmëria në këtë institucion është rritur në krahasim me vitet e mëparshme (2012, 2013 dhe 2014).² Sipas të dhënave statistikore, 56 përqind e qytetarëve kanë thënë se kanë besim në PK, 23 përqind janë shprehur se i besojnë deri diku, ndërsa 21 përqind e të anketuarve janë shprehur se nuk i besojnë PK-së.

Ekzistojnë disa arsye të cilat mund të hedhin dritë mbi rritjen e besueshmërisë së qytetarëve ndaj PK-së. Në radhë të parë, veprimet e fundit të PK-së, me theks të veçantë në luftimin e ekstremizmit të dhunshëm dhe mbikëqyrjen e grupeve ekstremiste në Kosovë³ duket ta kenë rritur besueshmërinë në PK. Në radhë të dytë vjen roli i fuqishëm i saj në ruajtjen e rendit publik, sidomos gjatë protestave të ndryshme, përfshirë dhe ato të dhunshme,⁴ me përdorim tejet të vogël të forcës së tepruar dhe duke u përballur në të njëjtën kohë me trysni të madhe politike qoftë nga qeveria, qoftë nga opozita.⁵ Argumenti i tretë mbështetet në perceptimin e përgjithshëm se PK-ja është funksionale dhe se qytetarët e shohin atë si adresën e parë të cilës mund t'i drejtohen për të gjitha problemet sociale dhe ato të lidhura me sigurinë. Në anën tjetër, ne kemi gjetur se qytetarët nuk konsiderojnë se PK-ja ka qenë e suksesshme në luftimin e krimit të organizuar dhe korrupsionit.⁶

Figura 1 – Besueshmëria në Policinë e Kosovës



² (Vrajolli & Kryeziu, 2015, f. 12).

³ (Koha Net, 2015a).

⁴ (Telegrafi, 2015a).

⁵ Kontributet e mbledhura nga grupet e fokusit që QKSS-ja i ka organizuar me hulumtuesit në terren për edicionin e pestë të BKS-së më 16 nëntor 2015.


⁶ (Mustafa, 2015)

1.1. Besueshmëria në Policinë e Kosovës sipas rajoneve

Me disa përjashtime, besueshmëria ndaj PK-së është e shpërndarë në mënyrë të ngjashme në të gjitha rajonet. Në këtë mënyrë, të anketuarit nga pjesa jugore e Mitrovicës (74 përqind), Prishtina (59 përqind), Gjilani (56 përqind) dhe Ferizaj (56 përqind) kanë shprehur nivelin më të lartë të besueshmërisë ndaj PK-së në vitin 2015. Këto rajone pasohen nga Prizreni (55 përqind) dhe Peja (53 përqind). Në anën tjetër, në rajonin e Gjakovës, kur janë pyetur për besueshmërinë e tyre ndaj PK-së, 43 përqind e qytetarëve kanë deklaruar se i besojnë PK-së.

Mirëpo, rajoni i katër komunave në veri pjesën veriore të Kosovës (veriu i Mitrovicës, Zveçani, Leposaviqi dhe Zubin Potoku), i banuar kryesisht nga komuniteti serb, është mjaft mosbesues kur bëhet fjalë për PK-në. Vetëm 27 përqind e qytetarëve të këtij rajoni i besojnë PK-së, 49 përqind i besojnë deri diku, derisa 24 përqind prej tyre nuk i besojnë fare. Sipas interpretimit tonë, ky qëndrim ndaj PK-së nuk duhet të vështrohet i izoluar, por duhet parë nga perspektiva e besueshmërisë që komuniteti serb ka ndaj të gjitha institucioneve tjera të Kosovës. Veç kësaj, institucionet e Kosovës kanë pasur gjatë tërë kohës qasje të kufizuar për të vepruar dhe për ta ushtruar autoritetin e tyre në pjesën veriore të Kosovës. PK-ja është duke kaluar nëpër një proces të konsolidimit në veri me qëllim të integritit të ish-anëtarëve të Ministrisë së Punëve të Brendshme të Serbisë dhe strukturave paralele serbe të sigurisë nën ombrellën e PK-së. Për më tepër, meqë PK-ja nuk vepron me kapacitete të plota në atë pjesë, grupet e krimtë të organizuar në pjesën veriore kanë kryer krime të ndryshme që kanë pasur një ndikim negativ në sigurinë e gjithmbarshme publike. Si rrjedhojë e kësaj, gjatë vitit 2015, disa pjesëtarë të PK-së kanë qenë të shënjestruar dhe sulmuar nga grupe të ndryshme kriminale.⁷

⁷ (KosovaPress, 2015); (Klan Kosova, 2015).

Figura 2 – Besueshmëria në Policinë e Kosovës sipas rajoneve të Kosovës

1.2. Besueshmëria në Policinë e Kosovës sipas përkatësisë etnike

Besueshmëria ndaj PK-së sipas përkatësisë etnike të qytetarëve ofron një pasqyrë më karakteristike të perceptimeve të popullatës së Kosovës ndaj këtij institucioni. Në mesin e shqiptarëve, 58 përqind i besojnë PK-së, 22 përqind i besojnë deri diku, derisa 20 përqind nuk i besojnë fare ose të paktën nuk e kanë perceptuar PK-në pozitivisht. Ngjashëm me popullatën shumicë shqiptare, pakicat e tjera,⁸ kanë në përgjithësi pikëpamje pozitive ndaj PK-së. Rreth 60 përqind e pakicave jo-serbe në Kosovë i besojnë PK-së, më pak se 20 përqind syresh i besojnë deri diku, ndërsa 21 përqind nuk i besojnë fare. Në anën tjetër, qytetarët e pakicës serbe kanë patur një perceptim krejt ndryshe kur janë pyetur në këtë hulumtim sa i përket nivelit të besueshmërisë së tyre ndaj PK-së. Në krahasim me shumicën e popullsisë shqiptare, si dhe grupeve të tjera pakicë të vendit, vetëm 29 përqind (ose 24 të anketuar serbë) i besojnë PK-së, 39 përqind (ose 32 të anketuar serbë) i besojnë deri diku, ndërsa 32 përqind (ose 26 të anketuar serbë) nuk i besojnë fare PK-së.


Përveç besueshmërisë së ulët ndaj PK-së, pakica serbe në veri të vendit ka besueshmëri madje edhe më të ulët ndaj institucioneve tjera të sigurisë në Kosovë, veçanërisht në Forcën e Sigurisë së Kosovës (FSK). Më pak se 10 përqind e qytetarëve serbë në pjesën veriore të vendit i besojnë FSK-së dhe më se 75 përqind nuk i besojnë fare, gjersa pjesa tjetër ose mbajnë qëndrim neutral ose nuk kanë ndonjë mendim në lidhje

⁸ Pakicat tjera përfshijnë turqit, boshnjakët, RAE, goranët, kroatët dhe malazezët.

me këtë institucion.⁹ Kjo mund të shpjegohet me faktin se PK-ja ka qasje dhe vepron në pjesën veriore të Kosovës, kështu që ka pasur disa kontakte dhe, si rrjedhojë, ngritje të besueshmërisë. Veç kësaj, komuniteti serb në veri të Kosovës është integruar mirë në PK, ndërkohë që shumë pak sosh janë integruar në FSK, e cila madje nuk operon fare në atë pjesë.¹⁰

Këto rezultate përfshijnë anketimin me të gjithë serbët që jetojnë në Kosovë dhe jo vetëm ata që jetojnë në veri të Kosovës. Përkundër faktit që komuniteti serb është i përfaqësuar mirë në radhët e PK-së, me rreth 13 përqind të personelit total të PK-së,¹¹ kjo nuk ka pasur si pasojë ndryshimin e qëndrimit të pakicës serbe ndaj PK-së në përgjithësi. Varësia e vazhduar e serbëve të Kosovës nga institucionet e Beogradit, përshtatja e institucioneve të tyre paralele të sigurisë të financuara nga Serbia në Kosovë, e sidomos në veri, si dhe refuzimi për t'i njohur institucionet e Kosovës, janë disa nga arsyet e shumta që kanë ndikuar në qëndrimet e serbëve ndaj PK-së dhe institucioneve tjera të Kosovës.

Figura 3 – Besueshmëria në Policinë e Kosovës sipas përkatësisë etnike



⁹ Baza e të dhënave e edicionit të pestë të BKS-së të realizuar nga QKSS-ja në tetor të vitit 2015.

¹⁰ (Telegrafi, 2015c).

¹¹ Kontributi i mbledhur nga punëtorja e dytë e Shkollës për Integrim Evropian – Moduli për Sigurinë dhe Sundimin e Ligjit i organizuar nga QKSS-ja prej 18-20 dhjetor 2015.

2. KONTAKTET E DREJTPËRDREJTA TË QYTETARËVE TË KOSOVËS ME POLICINË E KOSOVËS

Për ta kuptuar më mirë opinionin publik, matja e nivelit të kontaktit të të anketuarve me institucionet përkatëse mund të ofrojë më shumë njohuri rreth mendimeve të tyre për çështjet e paraqitura në këtë raport. Sipas gjetjeve të hulumtimit në terren, shumica e të anketuarve kanë pranuar se PK-ja është institucioni të cilin do ta kontaktonin të parin për nevoja të ndryshme, kryesisht për çështje të lidhura me sigurinë.¹² Kjo do të thotë se perceptimet e qytetarëve lidhur me PK-në janë të bazuara kryesisht në përvoja personale dhe kontakte të drejtpërdrejta.

Në edicionin e BKS-së për vitin 2015, të anketuarit e kanë radhitur PK-në në krye të listës së institucioneve më të kontaktuara në Kosovë. Për këtë arsye, nga gjithsej 1,070 të qytetarë anketuar, 618 sosh, ose 58 përqind, kanë deklaruar të kenë pasur kontakt të drejtpërdrejtë me PK-në, derisa 451 të anketuar, ose 42 përqind, kanë deklaruar se nuk kanë pasur, apo kanë mohuar të kenë pasur ndonjë kontakt me PK-në gjatë vitit 2015. Në perceptimin e tyre të përgjithshëm në lidhje me këtë institucion mund të ketë ndikuar edhe vetë natyra e punës së PK-së, e që ngërthen mbrojtjen e jetës dhe ofrimin e sigurisë së përgjithshme për të gjithë njerëzit në Kosovë.¹³ Veç kësaj, përgjigjet e të anketuarve lidhur me shpeshësinë e kontakteve përkohë me përqindjen e besueshmërisë së qytetarëve ndaj PK-së, ndonëse me disa dallime të vogla.¹⁴

Është e rëndësishme të theksohet se institucionet e tjera të sigurisë në Kosovë nuk kanë kontakte kaq të shpeshta me qytetarët e Kosovës sikundër PK-ja gjatë vitit 2015.¹⁵ Në krahasim me kontaktet me PK-së, shpeshësia e kontakteve të qytetarëve me FSK-në në po të njëjtën periudhë ka qenë mjaft e ulët. Kështu që, 21 përqind e të anketuarve kanë deklaruar se kanë pasur kontakt me FSK-në, gjersa 79 përqind prej tyre kanë deklaruar se nuk kanë pasur kontakt me këtë institucion. Kontakte me shpeshësi gati të ngjashme qytetarët kanë pasur edhe me misionin paqeruajtës të NATO-s në Kosovë (KFOR), ku 23 përqind e të anketuarve kanë deklaruar të kenë pasur kontakte me misionin e KFOR-it, derisa 77 përqind janë shprehur se nuk kanë pasur kontakt me këtë mision ndërkombëtar. Sipas të dhënave të këtij hulumtimi, me përjashtim të Policisë, kontaktet e qytetarëve me institucionet e tjera të sigurisë (FSK-ja dhe KFOR-i) kanë qenë më tepër të formës së vrojtimeve pasive nga ana e qytetarëve sesa kontakte të drejtpërdrejta.


¹² Kontributet e mbledhura nga grupet e fokusit që QKSS-ja i ka organizuar me hulumtuesit në terren për edicionin e pestë të BKS-së më 16 nëntor 2015.

¹³ Për më shumë hollësi, shih nenin 10 të Ligjit Nr. 04/L-076 për Policinë.

¹⁴ Shih Figurën 1.


¹⁵ (Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë, 2015, f. 11).

Figura 4 – Kontaktet e qytetarëve të Kosovës me Policinë e Kosovës dhe institucionet e tjera të sigurisë




Nga ana tjetër, kur shqyrtohen perceptimet e të anketuarve lidhur me kontaktet e tyre me institucionet e sigurisë sipas rajoneve, duket të ketë dallime nga njëri rajon në tjetrin. Rajonet e Kosovës me numër më të madh të popullatës si Prizreni (70 përqind), Gjilani (63 përqind), Prishtina (54 përqind) dhe Peja (53 përqind) kanë pasur kontakte më të shpeshta me PK-në sesa ato me numër më të vogël të popullsisë. Ndërsa, të anketuarit nga rajoni i Ferizajt (48 përqind), Mitrovicës (47 përqind) dhe Gjakovës (47 përqind) janë shprehur se kanë pasur më pak kontakte me PK-në në krahasim me rajonet e tjera. Sa i përket veriut të Kosovës, të anketuarit nga ky rajon kanë pasur kontakte më të shpeshta me PK-në gjatë vitit 2015. Pothuajse të gjithë të anketuarit (98 përqind) kanë deklaruar të kenë pasur kontakte me PK-në.

Figura 5 – Kontaktet e qytetarëve të Kosovës me Policinë e Kosovës sipas rajoneve të Kosovës




Nga ana tjetër, siç tregon figura e mëposhtme, kur të krahasohet shpeshësia e kontaktit të qytetarëve të PK-së me atë të FSK-së, atëherë edhe në këtë rast situata rezulton të jetë ndryshe. Në të gjitha rajonet e Kosovës, qytetarët kanë pasur shpeshësi shumë më të ulët të kontaktit me FSK-në sesa me PK-në.

Figura 6 – Kontaktet e qytetarëve të Kosovës me Forcën e Sigurisë së Kosovës sipas rajoneve të Kosovës



Pothuajse njëjtë si FSK-ja, edhe me KFOR-in qytetarët kanë pasur nivel të ulët të kontaktit. Këtë më së miri e tregon edhe figura në vijim, ku fare pak rezultojn të ketë dalje me FSK-në.


Figura 7 – Kontaktet e qytetarëve të Kosovës me KFOR-in sipas rajoneve të Kosovës



Në këtë edicion të BKS-së janë paraqitur rezultate të reja mbi kontaktet e të anketuarve me njësi të veçanta që veprojnë në kuadër të PK-së. Qëllimi është që të ofrohet një in-

terpretim sa më i thellë i të dhënave lidhur me përvojat dhe kontaktet e të anketuarve me zyrtarët policor dhe me njësitë brenda PK-së. Sipas figurës së mëposhtme, departamenti policor me të cilin kanë qenë më së shpeshti në kontakt të anketuarit është Policia Kufitare. Pra, 44 përqind e qytetarëve kanë pasur kontakt të drejtpërdrejtë me zyrtarët policor të cilët punojnë në këtë departament. Veç kësaj, 37 përqind e të anketuarve kanë qenë në kontakt të drejtpërdrejtë me Policinë e Trafikut dhe ky rezultat sugjeron se pjesëtaret e kësaj njësie të PK-së duhet t'i kushtojnë më tepër vëmendje sjelljes, sidomos kur janë në detyrë. Për shembull, gjatë vitit 2015 policët e trafikut janë parë nga qytetarët teksa po i shkelnin rregullat e trafikut dhe sjelljet e zyrtarëve policor ndaj qytetarëve nuk kanë qenë shembullore.¹⁶ Njësitë tjera policore kanë pasur më pak kontakte me qytetarët. Për shembull, vetëm rreth 16 përqind e të anketuarve kanë deklaruar të kenë pasur kontakte me administratën e PK-së, të pasuar nga pjesëtarët e policimit në bashkësi (16 përqind), Njësitë Speciale të Policisë (5 përqind) dhe Njësia e Hetimeve të Policisë (4 përqind).

Figura 8 – Kontaktet e qytetarëve të Kosovës me njësitë e Policisë së Kosovës



¹⁶ Për më shumë hollësi, shih video materialin tek: <<http://goo.gl/bnAeQq>>. Qasur më 14 janar 2016.

3. KORRUPSIONI NË POLICINË E KOSOVËS

Përkundër besueshmërisë së madhe dhe kontakteve relativisht të shpeshta me PK-në, sipas mendimit të qytetarëve, kjo e fundit duket të jetë prekur nga korrupsioni. Megjithatë, vlen të përmendet se, në krahasim me institucionet e tjera, qytetarët e kanë radhitur PK-në si institucionin e dytë vendor më së paku të korruptuar në Kosovë.¹⁷

Prandaj, 41 përqind e të anketuarve kanë ndarë mendimin se PK-ja nuk është e korruptuar, në krahasim me 27 përqind sosh që kanë pohuar të kundërtën. Ndërkaq, 28 përqind e të anketuarve kanë deklaruar se PK-ja është deri diku e korruptuar dhe më pak se 5 përqind prej tyre nuk kanë dijeni ose nuk kanë pasur ndonjë mendim për këtë çështje. Duke ditur se PK-ja është larg nga të qenit e përsosur, mund të thuhet se qëndrimet e qytetarëve të Kosovës janë përgjithësisht pozitive kur është fjala për perceptimin e tyre për korrupsionin në radhët e PK-së.

Figura 9 – Perceptimet e qytetarëve për korrupsionin në Policinë e Kosovës





Figura e mëposhtme paraqet dallimet në mendimet e të anketuarve rreth korrupsionit në PK sipas rajoneve. Sipas perceptimeve të qytetarëve të rajoneve përkatëse, në krahasim me rajonet e tjera, të anketuarit nga Gjakova duket se besojnë se PK-ja është më e korruptuar, ku 43 përqind e të anketuarve kanë qenë të mendimit se PK-ja është e korruptuar, të pasuar nga rajoni i Prizrenit (34 përqind) dhe Ferizajt (31 përqind). Në anën tjetër, vetëm 12 përqind e qytetarëve nga jugu i Mitrovicës kanë qenë të mendimit se PK-ja është e korruptuar, në krahasim me 22 përqind të të anketuarve nga Gjilani dhe veriu i Mitrovicës përkatësisht të cilët besonin se PK-ja ishte e korruptuar. Gjithashtu, 23 përqind e të anketuarve nga rajoni i Prishtinës dhe 32 përqind prej tyre nga Peja besonin se PK-ja është e korruptuar.

¹⁷ (Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë, 2015, f. 17).

Figura 10 – Perceptimet e qytetarëve për korrupsionin në Policinë e Kosovës sipas rajoneve të Kosovës




Ky botim i BKS-së, gjithashtu, ofron të dhëna dhe interpretimin tonë në lidhje me mendimin e të anketuarve lidhur për nivelin e rryshfetmarrjes në PK, e që është një ndër çështjet më të ndjeshme kur bëhet fjalë për matjen e integritetit në polici. Vlen të ceket se informatat e paraqitura në Figurën 9 tregojnë vetëm rezultatet për të anketuarit të cilët kanë deklaruar të kenë pasur kontakte të drejtpërdrejta¹⁸ me PK-në. Ky filtër siguron të dhëna më të sakta lidhur me mundësinë e rryshfetmarrjes nga ana e pjesëtarëve të PK-së. Kështu që, rezultatet tregojnë se 95 përqind e të anketuarve (ose 567 qytetarë të anketuar) janë deklaruar shprehimisht se gjatë kontaktit me pjesëtarë të PK-së ata kurrë nuk u kanë kërkuar para, dhuratë ose çfarëdolloj rryshfeti tjetër. Ndërkaq, vetëm 2.3 përqind e këtyre të anketuarve kanë pranuar t’u kenë dhënë para ose dhurata zyrtarëve policor, derisa pjesa tjetër kanë deklaruar se u kanë paguar drekë/darkë zyrtarëve policor apo u kanë premtuar ndonjë nder në këmbim. Për më tepër, vrojtimet tona gjatë hulumtimit në terren sugjerojnë se qytetarët nuk janë të mirinformuar për format e korrupsionit të mundshëm në radhët e PK-së. Veç kësaj, disa favore sikurse drekat/darkat apo favore të tjera që mund t’u jenë ofruar potencialisht zyrtarëve policor nuk janë perceptuar si korrupsion nga të anketuarit.¹⁹ Kjo tregon se të anketuarit mund të kenë pasur frikë të pranojnë se kanë korruptuar ose u kanë dhënë rryshfet zyrtarëve policor gjatë kontaktit me ta. Veç kësaj, nuk ka ndonjë mekanizëm për verifikimin e mendimeve apo perceptimeve të qytetarëve për atë nëse qytetarët u kanë

¹⁸ Për më shumë hollësi rreth kontakteve të drejtpërdrejta të të anketuarve me PK-në, shih Figurën 4.

¹⁹ Kontributet e mbledhura nga grupet e fokusit që QKSS-ja i ka organizuar me hulumtuesit në terren për edicionin e pestë të BKS-së më 16 nëntor 2015.


dhënë vërtet para/dhurata PK-së apo jo. Prandaj, institucionet përkatëse të Kosovës në fushën e luftimit të korrupsionit duhet të bëjnë fushata publike kreative për rreziqet nga të gjitha llojet e korrupsionit.

Figura 11 – Përvojat e qytetarëve me korrupsion gjatë kontaktit të tyre me Policinë e Kosovës




Në këtë anketë të BKS-së, qytetarët janë pyetur se kujt do t'i drejtoheshin për raportimin e rasteve të korrupsionit në radhët e PK-së në qoftë se përballen me ndonjë rast të tillë. Rezultatet tregojnë se 28 përqind e të anketuarve do t'i drejtoheshin së pari stacionit më të afërt policor. Rreth 25 përqind e të anketuarve kanë thënë se rastet e tilla do t'i raportonin në Agjencinë Kundër Korrupsionit, gjersa 17 përqind prej tyre kanë thënë se do t'ua raportonin mediave. Sipas të anketuarve, adresa tjera të mundshme për raportimin e korrupsionit policor janë IPK-ja (13.1 përqind), përkatësisht komandanti i stacionit të policisë (6.7 përqind), ndonjë mik i cili punon në Polici (2.7 përqind), organizatat joqeveritare (2.5 përqind), ndërsa më pak se 6 përqind e të anketuarve nuk dinë se ku do të raportonin për rastet e korrupsionit në polici.

Figura 12 – Perceptimet e qytetarëve se kujt do t'i raportonin për rastet e korrupsionit në Polici



Sa i përket mendimit të tyre për atë se kush duhet ta luftojë korrupsionin në PK, të anketuarit besojnë se përgjegjësia për luftimin e korrupsionit i takon në radhë të parë Qeverisë së Kosovës. Pothuajse 30 përqind e qytetarëve kanë deklaruar se korrupsionin në PK duhet ta luftojë kjo e fundit, krahasuar me 22 përqind të anketuarve që kanë thënë se Agjencia Kundër Korrupsionit është ajo e cila duhet ta luftojë korrupsionin në PK. Duhet vënë në dukje se besueshmëria e qytetarëve të Kosovës ndaj Qeverisë së Kosovës dhe Agjencisë Kundër Korrupsionit ka qenë shumë e ulët gjatë vitit 2015.²⁰ Për më tepër, 18 përqind e të anketuarve besojnë se IPK-ja duhet të jetë përgjegjëse për ta luftuar korrupsionin në radhët e PK-së. Vetëm 8 përqind e qytetarëve kanë qenë të mendimit se korrupsionin brenda PK-së duhet ta luftojë Prokurori i Shtetit. Fakti që një numër kaq i vogël i të anketuarve kanë renditur prokurorinë në mesin e institucioneve që duhet ta luftojnë korrupsionin në PK tregon se qytetarët ose kanë pak informata rreth asaj se kush mban përgjegjësinë për luftimin e korrupsionit ose i besojnë pak prokurorisë.

²⁰ (Avdiu & Përteshi, 2015, f. 7).


Figura 13 – Perceptimet e qytetarëve se kush duhet ta luftojë korrupsionin në Polici

4. (MOS)NDIKIMI POLITIK NË POLICI

Në kuadër të këtij hulumtimi, qytetarët janë pyetur se çfarë mendimi kanë lidhur me ndikimin politik në PK. Vlen të ceket se shumica prej tyre (mbi 50 përqind) besonin se PK-ja punon për interesat e qytetarëve. Megjithatë, duhet vënë në dukje se ky anketim i opinionit publik është realizuar gjatë muajit tetor të vitit 2015, disa javë para se të fillonin protestat e opozitës kundër Qeverisë, me ç’rast disa deputetë të Kuvendit të Kosovës nga radhët e opozitës u arrestuan nga ana e PK-së gjatë muajve nëntor dhe dhjetor të vitit 2015.²¹

Si rrjedhojë, 53 përqind e të anketuarve besonin se PK-ja i mbron interesat e qytetarëve. Nga ana tjetër, 23 përqind e të anketuarve ishin të mendimit se PK-ja është në shërbim të Qeverisë së Kosovës, ndërsa 12 përqind pohuan se PK-ja i ka mbrojtur interesat e partive politike dhe 5 përqind besonin se ajo punon për interesa të klaneve të ndryshme. Vetëm 4 përqind e të anketuarve ishin të mendimit se PK-ja punonte për interesat e menaxhmentit të lartë të PK-së. Duke u nisur nga këto perceptime, mund të arrihet në përfundimin se deri në tetor të vitit 2015 të anketuarit besonin se PK-ja ka arritur të ruajë ekuilibrin për të qenë në shërbim të interesit të përgjithshëm publik dhe interesave të qytetarëve.


²¹ Për më shumë hollësi, shih materialet në vijim: <<http://goo.gl/hc8qOC>>; <<http://goo.gl/6E8krm>>. Qasur më 15 janar 2016.

Figura 14 – Perceptimet e qytetarëve se kujt i shërben Policia e Kosovës

5. BASHKËPUNIMI NDËRMJET POLICISË DHE QYTETARËVE


Ky hulumtim ka matur edhe nivelin e bashkëpunimit ndërmjet qytetarëve dhe zyrtarëve policor në terren. Gjetjet tregojnë se ekzistojnë katër faktorë kyç, që janë paraqitur në figurën e mëposhtme, e të cilët pengojnë këtë bashkëpunimin. Këta katër faktorë kyç që pengojnë bashkëpunimin mes qytetarëve dhe policisë janë si vijon:

- Frikësohem se mund të më zbulohet identiteti nga Policia (56 përqind);
- Edhe nëse raportoj, Policia nuk është efi-kase në luftimin e krimit dhe veprave të tjera negative (49 përqind);
- Frikësohem nga etiketimi i qytetarëve si “spiun” (47 përqind);
- Kam mungesë informacioni se si mund të kontaktohet Policia (43 përqind).

Figura 15 – Pengesat kryesore ndaj bashkëpunimit të qytetarëve me policët

Gjithashtu, të anketuarit janë pyetur të jepnin mendimin e tyre se si mund të përmirësohet siguria publike në vend. Rreth 95 përqind prej tyre kanë qenë të mendimit që për përmirësimin e sigurinë publike është e nevojshme të rritet bashkëpunimi mes qytetarëve dhe PK-së dhe vetëm 4 përqind ishin të mendimit se kjo është deri diku e nevojshme. Ndërkohë, vetëm 1 përqind e të anketuarve besonin se kjo nuk është mënyra e duhur për përmirësimin e sigurisë publike. Nga ana tjetër, prej të gjithë të anketuarve, 79 përqind e tyre ishin të mendimit se siguria publike mund të rritet me prani më të shpeshtë të PK-së në trafik, derisa 12 përqind mendonin se një gjë e tillë është deri diku e nevojshme dhe më pak se 10 përqind sosh besonin se kjo ishte e panevojshme. Rezultatet e tilla janë të pritshme duke marrë parasysh që, për shembull, në krahasim me vitet e shkuara, viti 2015 u karakterizua nga një rritje e numrit të aksidenteve në komunikacion në Kosovë, meqë vlerësohet se gjatë tërë vitit kanë ndodhur rreth 15,000 incidente.²²

Figura 16 – Përmirësimi i sigurisë publike




²² (Idrizi, 2015).

6. PERCEPTIMI I QYTETARËVE PËR INSPEKTORATIN POLICORTË KOSOVËS

Duke marrë parasysh fushëveprimin dhe përgjegjësitë e IPK-së, e që është mbikëqyrja e pjesëtarëve të PK-së me qëllim të përmirësimit të kryerjes së detyrave dhe profesionalizmit të tyre, BKS-ja e ka vlerësuar si shumë të rëndësishme matjen e perceptimit të publikut përkitazi me këtë institucion. Ndonëse besueshmëria ndaj këtij institucioni ka dalë të jetë më e ulët në krahasim me PK-në në përgjithësi, perceptimet e qytetarëve lidhur me IPK-në mund të vlerësohen se deri diku janë pozitive.

Siç shihet në figurën e mëposhtme, 40 përqind e të anketuarve deklaruan se i besojnë IPK-së, derisa 27 përqind janë përgjigjur se i besonin deri në një masë. Veç kësaj, 30 përqind e të anketuarve deklaruan se nuk i besojnë IPK-së. Përkundër këtyre rezultateve, institucionet përkatëse të Kosovës kanë kritikuar shpesh IPK-në për mungesë të aftësive profesionale në mbikëqyrjen e PK-së dhe kanë bërë thirrje për paanshmëri më të madhe në kryerjen e punëve të veta.²³


Figura 17 – Besueshmëria në Inspektoratin Policor të Kosovës



Në përgjithësi, opinioni publik në Kosovë lidhur me IPK-së nuk është i bazuar në kontaktet e drejtpërdrejta apo përvojat personale të qytetarëve me këtë institucion – kryesisht për shkak të natyrës së punës së këtij institucioni. Si pasojë e kësaj, vetëm 15 përqind e të anketuarve pranuan të kenë pasur kontakte me IPK-në gjatë vitit 2015 në krahasim me 85 përqind prej tyre të cilët nuk kishin pasur as edhe një kontakt të vetëm me këtë institucion. Gjithashtu, vlen të përmendet se IPK-ja vazhdimisht shmang paraqitjet dhe aktivitetet publike, gjë që e bën edhe më të vështirë për publikun e gjerë që të jetë në dijeni se deri në çfarë mase e kryen funksionin e vet IPK-ja si institucion.

²³ Kontributet e mblidhura nga grupet e fokusit që QKSS-ja i ka organizuar me hulumtuesit në terren për edicionin e pestë të BKS-së më 16 nëntor 2015.

Figura 18 – Kontaktet e qytetarëve të Kosovës me Inspektoratin Policor të Kosovës



BIBLIOGRAFIA

Burimet parësore:

- Baza e të dhënave e edicionit të pestë të Barometrit Kosovar të Sigurisë. Hulumtimi është realizuar nga Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë gjatë periudhës 21 – 29 tetor 2015.
- Dy grupet e fokusit të organizuara nga Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë me hulumtuesit e terrenit të Barometrit Kosovar të Sigurisë më 16 nëntor 2015.
- Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë (2015). *Barometri Kosovar i Sigurisë – Edicioni i pestë*. Prishtinë: Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë. Qasur më 13 janar 2016, në <<http://goo.gl/MGrfEg>>

Burime të tjera:

- Avdiu, P., & Përteshi, S. (2015). *Perceptimet e qytetarëve për integritetin në Policinë e Kosovës*. Prishtinë: Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë.
- Idrizi, E. (8 dhjetor 2015). *Rritet numri i aksidenteve në komunikacion*. Qasur më 14 janar 2016, në <<http://goo.gl/wLWkqZ>>
- Klan Kosova. (21 tetor 2015). *Sulmohet me armë një polic në veri të Mitrovicës*. Qasur më 12 janar 2016, në <<http://goo.gl/Ssv5Lo>>
- Koha Net. (11 korrik 2015a). *Policia: Arrestohen 5 të dyshuar për terrorizëm*. Qasur më 12 janar 2016, në <<http://goo.gl/fXx0pN>>
- Koha Net. (28 janar 2015b). *Vetëvendosje e Qeveria akuzojnë njëra tjetrën për dhunë, KMDLNJ-ja të dyja [video]*. Qasur më 16 janar 2016, në <<http://goo.gl/VY6Edx>>
- Koha Net. (18 nëntor 2015c). *Arrestohet Donika Kadaj Bujupi [video]*. Qasur më 15 janar 2016, në <<http://goo.gl/6E8krm>>
- Konushevc, A. (1 janar 2016). *Viti 2015, vit i humbur kundër korrupsionit*. Qasur më 12 janar 2016, në <<http://goo.gl/mROJAH>>
- KosovaPress. (10 tetor 2015). *Sulm me granatë ndaj shtëpisë së policit*. Qasur më 12 janar 2016, në <<http://goo.gl/EeUdEy>>
- Ligji Nr. 04/L-076 për Policinë.

- Mustafa, Q. (6 tetor 2015). *Policia sërish në aksion kundër fajdeve*. Qasur më 12 janar 2016, në <<http://goo.gl/ZnXLXX>>
- Dëgjimi publik i Komisionit të Kuvendit të Kosovës për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për Policinë më 15 dhjetor 2015.
- Punëtorja e dytë e Shkollës për Integritime Evropiane – Moduli për Sigurinë dhe Sundimin e Ligjit i organizuar nga Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë prej 18 – 20 dhjetor 2015.
- Telegrafi. (27 janar 2015a). *Protesta e sotme në 101 fotografi (Foto)*. Qasur më 12 janar 2016, në <<http://goo.gl/PQCTNI>>
- Telegrafi. (28 dhjetor 2015b). *Skandaloze, ja se si Policia e Kosovës shkel rregullat e komunikacionit (Video)*. Qasur më 14 janar 2016, në <<http://goo.gl/bnAeQq>>
- Telegrafi. (24 prill 2015c). *NATO: Kosova ka pranuar, FSK në veri veç me lejen e KFOR-it*. Qasur më 18 janar 2016, në <<http://goo.gl/66y8G7>>
- Vrajolli, M., & Kryeziu, P. (2015). *Trends of Citizens' Trust towards the Security and Justice Institutions in Kosovo - Covering Period: 2012-2015*. Prishtina: Kosovar Centre for Security Studies. Qasur më 11 janar 2016, në <<http://goo.gl/l2EI47>>
- Zëri i Amerikës. (28 nëntor 2015). *Arrestohet Albin Kurti*. Qasur më 15 janar 2016, në <<http://goo.gl/hc8qOC>>

Falënderim

Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë i shpreh mirënjohje të veçantë të gjithë atyre që kontribuuan në këtë studim të Barometrit Kosovar të Sigurisë për vitin 2015, si dhe për rolin e tyre të rëndësishëm në kryerjen e hulumtimeve në terren, mbikëqyrjen dhe monitorimin e përpunimit të të dhënave.

Ekipi e kishte këtë përbërje: Alba Boshnjaku, Adnan Kryeziu, Agnesa Haxhiu, Agon Ahmeti, Albinë Bricori, Andi Emini, Argjira Kameri, Arian Mavriqi, Diellza Kosumi, Durim Xhemajli, Erna Buçaj, Gëzim Stavileci, Granit Hyseni, Gresa Sermaxhaj, Kastriot Grapci, Kujtim Kryeziu, Kushtrim Mustafa, Lirim Krasniqi, Malisa Zymeri, Marigona Dubovci, Milan Lazarevic, Premtim Fazlija, Rina Koleci, Rinon Arifi, Rita Nushi, Roland Sylejmani, Rron Gashi, Taulant Boshnjaku, Valëza Mjeku, Verona Kadriu, Yllza Xheladini.

Publikimet e mëparshme në kuadër të Barometrit Kosovar të Sigurisë

Perceptimet e Publikut për Politikën e Jashtme dhe Dialogun me Serbinë, Shkurt 2016

Barometri Kosovar i Sigurisë - Edicioni i pestë, Dhjetor 2015

Trendët e besueshmërisë së qytetarëve ndaj institucioneve të sigurisë dhe të drejtësisë në Kosovë për periudhën 2012-2015, Shtator 2015

Perceptimet e Qytetarëve për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, Janar 2015

Perceptimet e Publikut për Politikën e Jashtme dhe Dialogun me Serbinë, Janar 2015

Barometri Kosovar i Sigurisë - Edicioni i katërt, Dhjetor 2014

Barometri Kosovar i Sigurisë - Edicioni i tretë, Dhjetor 2013

Barometri Rajonal i Sigurisë, Dhjetor 2013

Barometri Kosovar i Sigurisë - Zërat e Kosovës: Vështrimet dhe Perceptimet, Maj 2013

Barometri Kosovar i Sigurisë - Edicioni i parë, Dhjetor 2012

Publikimet e ardhshme në kuadër të Barometrit Kosovar të Sigurisë

Perceptimet e Qytetarëve për Sigurinë Publike në Kosovë, Mars 2016

Katalogimi në botim – **(CIP)**

Biblioteka Kombëtare e Kosovës "Pjetër Bogdani"

351.746.1(496.51)(048)

327(497:496.51)(048)

Barometri Kosovari i Sigurisë : Perceptimet e qytetarëve për integritetin në Policinë e Kosovës / Interpretues i të dhënave Plator Avdiu.- Edicion Special. - Prishtinë : Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë, 2016.
– 31 f. – 21 cm.

Bibliografia : f. 28-29

1.Avdiu, Plator

ISBN 978-9951-679-37-4

ISBN 978-9951-679-37-4



9 789951 679374

www.qkss.org